



REPUBLIKA KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E DREJTËSISË - MINISTRY OF JUSTICE

SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS - KORREKТИVNA SLUŽBA KOSOVËS  
KOSOVO CORRECTIONAL SERVICE

Njësi i vogël Drejtësive Ushqimore  
Nr./Br./No. 375 Date/Date/Year 27.03.2025  
Qytet/District/Place

PRISHTINË



## Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice

Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Correctional Service

Drejtoria e Përgjithshme

Prishtinë: 27.03.2025

Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 1, nën paragafi 1.10 të ligjit nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës nxjerr:

### V E N D I M

I. Miratohet Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Zyrtarët Korrektues.

II. Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale do të zbatohet nga të gjithë Zyrtarët Korrektues në Institucionet Korrektuese.

III. Vendimi hyn në fuqi nga data 01 Prill 2025.

Ismail Dibrani

Drejtor i Përgjithshëm  
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Vendimi ju dërgohet:

1. Institucioneve Korrektuese;
2. Arkivit të SHKK-së.



MINISTRIA E DREJTËSISË - REPUBLIKA KOSOVË - REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVË - GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E DREJTËSISE - MINISTERSTVO PRAVDE - MINISTRY OF JUSTICE

Njësia Korrektive i Kosovës - Korrektivna Služba Kosova  
KOSOVO CORRECTIONAL SERVICE

Njësia e zgjedhur/Selected Unit: 375 Date/Date: 27/03/2025  
Nr. Nr./No.: 375 Date/Date: 27/03/2025  
Shtojf/Dated/Date:

PROTOKOLI/PROTOCOL



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice  
Shërbimi Korrektyes i Kosovës/Korrektivna Služba Kosova/Kosovo Correctional Service  
Drejtoria e Përgjithshme

## SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS

KODI I ETIKËS DHE SJELLJES PROFESIONALE PËR ZYRTARËT  
KORREKTUES



Prishtinë, Mars 2025

## **Neni 1 Hyrje**

Duke marrë parasysh rolin, misionin dhe veprimtarinë ligjore të Shërbimit Korrektues të Kosovës është e rëndesishme dhe esenciale nxjerrja e kodit të etikës dhe sjelljes profesionale për zyrtarët korrektues me qëllim të zbatimit të një sjellje etike dhe profesionale me integritet të lartë, që ngritet vlerat dhe performancën e Shërbimit Korrektues të Kosovës si agjenci ekzekutive e sigurisë dhe për të rritur besueshmërinë e publikut në zbatimin e mandatit ligjor të Shërbimit Korrektues të Kosovës sipas standardave ndërkontrolluese.

## **Neni 2 Statusi i Shërbimit Korrektues të Kosovës**

1. Shërbimi Korrektues i Kosovës është agjenci ekzekutive e sigurisë cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Shërbimi Korrektues i Kosovës ka shenjën identifikuese, uniformën, flamurin dhe emblemën të cilat miratohen nga Ministri pas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së.

## **Neni 3 Qëllimi**

Qëllimi i këtij kodi është përcaktimi i standardeve të sjelljes profesionale në çdo nivel të organizimit bazuar në vlerat dhe parimet që duhet të respektohen nga zyrtarët korrektues gjatë ushtrimit të funksioneve brenda dhe jashtë vendit dhe sjelljeve etike jashtë detyrës zyrtare, që të arrihen standarde të larta të ndershmërisë, përgjegjshmërisë, integritetit, illogaridhënieve dhe parandalimit të sjelljeve jo etike.

## **Neni 4 Fushëveprimi**

Ky kod i etikës zbatohet nga të gjithë zyrtarët korrektues në të gjitha institucionet korrektuese. Kodi i etikës duhet të zbatohet gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare dhe jashtë saj, pavarësisht nëse sjellja e konsideruar si një gabim etik përbën shkelje të ligjit apo jo. Injorimi i kodit të etikës mund të jetë bazë për përgjegjësinë disiplinore të zyrtarit korrektues.

## **Neni 5 Parimet Themelore**

1. Personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës është i obliguar t'i zbatoj parimet themelore si në vijim:

1.1. Ligjshmërisë - personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës së ushtrojnë të gjitha detyrat në bazë të Kushtetutës, instrumenteve të aplikueshme ndërkontrolluese si dhe legjislacionit në fuqi;

1.2. përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit - personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës zbaton parimet e përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit si një kufizim në ushtrimin e detyrave dhe autorizimeve. Autorizimet ushtrohen vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në atë nivel që nevojitet për t'i arritur objektivat ligjore të SHKK-së dhe me pasoja sa më pak të dëmshme dhe për kohë sa më të shkurtër të mundshme;

- 1.3. detyrimit për t’iu përgjigjur kërkesave dhe ankesave - personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës duhet të përgjigjen ndaj kërkesave, ankesave të dorëzuara nga të burgosurit, individët ose organe të tjera;
- 1.4. efektshmërisë dhe efikasitetit - personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve, rregullave dhe procedurave administrative dhe të sigurisë përmëbushjen e objektivave të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- 1.5. përgjegjësisë - personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës është i detyruar që të raportojë, shpjegojë dhe të përgjigjet për pasojat e vendimeve, veprimeve dhe mosveprimeve të tyre;
- 1.6. paanësisë dhe pavarësisë profesionale - personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës nuk i lejohet njëanshmëria, që do të thotë të ketë një predispozitë në favor të një rezultati të caktuar gjatë vlerësimit të një situate, duke shkaktuar si rrjedhojë një dëm të pajustifikueshëm për interesin e përgjithshëm ose për të drejtën e palëve të tjera të interesuara;
- 1.7. shmangies së konfliktit të interesit - personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës duhet të mos lejojë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë konflikt interesit. Personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjisacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit;
- 1.8. parimit të mundësive të barabarta - personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës ka mundësi të barabarta për pjesëmarrje në aktivitetet e Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- 1.9. parimit të respektimit të drejtave dhe lirive themelore të njeriut - personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës është i obliguar të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;
- 1.10. parimit të mos-diskriminimit - nuk lejohet kurfarë diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual. Përjashtimisht kritereve të moshës dhe sigurimit të kuotës gjinore për punësim, për shkak të specifikave dhe natyrës së punës për zyrtarë korrektues nuk konsiderohet diskriminim;
- 1.11. llogaridhënes - zyrtarët publik të Shërbimit Korrektues të Kosovës obligohen që të japid illogari lidhur me ushtrimin e autorizimeve të tyre krahas ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive të punës në pajtim me legjisacionin përkatës në fuqi.
- 1.12. parimi i mirësjelljes - zyrtari korrektues në punën e tij udhëhiqet nga parimi i sjelljes profesionale në raport me stafin, të dënuarit, si dhe personat e tjerë.

## Neni 6

### Integriteti

1. Integriteti është cilësi e zyrtarit korrektues bazuar në karakterin e lartë moral dhe profesional, i cili duhet të jetë i dukshme dhe i njohur gjatë tërë kohës në harmoni me veprimet e tij. Të

vepruarit me integritet për një zyrtar do të thotë të punojë dhe të jetë përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e tij.

2. Cenimi i integritetit mund të përfshijë një veprim ose mosveprim, qoftë gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare si dhe jashtë detyrës që është në kundërshtim me ligjin, politikat dhe strategjitet e sistemit korrektues, udhëzimet administrative ose një veprim që përbën vepër penale.

### **Neni 7 Konfidencialiteti**

Zyrtari korrektues i nënshtrohet detyrimi të konfidencialitetit. Ky detyrim nënkupton se ai nuk duhet të jep informacion konfidencial, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, që do të rrezikonte një hetim në pritje ose procedim penal, që do të dëmtonte integritetin, dinjitetin, sigurinë dhe të drejtat e privatësisë së çdo personi ose që do të shkelte të drejtat e të miturve dhe të personave të privuar nga liria që janë në mbajtje në institucionë korrektuese.

### **Neni 8 Sjellja Etike**

1. Secili zyrtar duhet të jetë shembull me sjelljen e tij të mirë për të gjithë të tjera, duke punuar me profesionalizëm, ndërgjegje dhe besueshmëri.
2. Zyrtari korrektues duhet të jetë i sjellshëm dhe të ketë komunikim profesional si me kolegët, të burgosurit si dhe personelin tjeter të institucioneve publike apo private.
3. Zyrtari korrektues duhet të sillet në mënyrë korrekte në çdo kohë dhe në çdo situatë. Paraqitja e zyrtari korrektues duhet të jetë e denjë si në punë ashtu edhe gjatë kohës së lirë. Sjelljet jo profesionale dhe të pahijshme në jetën private mund të dëmtojnë imazhin e Shërbimit Korrektues të Kosovës.
4. Zyrtari korrektues nuk duhet t'i zbulojë personave të paautorizuar informacionin që i është bërë i njohur për shkak të detyrës së tij/saj.
5. Zyrtari korrektues nuk duhet të përkrahë apo tolerojë në asnjë mënyrë dhunën ose urrejtjen ndaj të burgosurve dhe duhet të përmbahet nga përdorimi i shprehjeve etiketuese apo nënçmuese për shkak të veprës penale.
6. Zyrtari korrektues edhe kur gjendet në situata të komplikuara duhet të merr vepime dhe vendime të natyrës etike dhe të vlerësoj pasojat e vendimit në atë situatë.
7. Zyrtari korrektues duhet te demonstrojë etikë dhe integritet të lartë personal në parandalimin dhe luftimin e dukurive negative dhe korruptionit të cilat dëmtojnë vlerat e Shërbimit Korrektues të Kosovës.
8. Zyrtari korrektues duhet të veprojë me etikë të lart profesionale në përdorimin e autoritetit dhe autorizimeve dhe mos të lejojë tejkalimin e autorizimit, por të veprojë vetëm brenda kufijve të kompetencave.
9. Zyrtari korrektues duhet të përbahet nga veprimet, publikimet dhe shpërndarja e deklarimeve me përbajtje politike.

**Neni 9**  
**Ngacmimi Seksual**

1. Ngacmimi seksual është i ndaluar në çdo formë të paraqitjes verbale apo fizike, andaj zyrtarët korrektues duhet të përbahen nga çdo veprim i cili mund të ketë elemente të ngacmimit seksual gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare dhe jashtë saj.
2. Në çdo rast kur zyrtarët korrektuese janë të implikuar në veprime të cilat nxisin ngacmimin seksual mund të përballen me procedura disiplinore dhe penale.

**STANDARDET E ETIKËS PROFESSIONALE**

**Neni 10**  
**Kryerja e Detyrave me Përgjegjësi**

1. Personeli do t'i realizojë detyrat e veta në mënyrë profesionale, të ndershme, të përgjegjshme, me integritetit dhe llogaridhënie, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi duke respektuar vlerat dhe parimet e Shërbimit Korrektues të Kosovës.
2. Deklaratat që kritikojnë punonjësit e tjerë apo shërbimin mund të jepen vetëm nëse mund të konfirmohen ndryshe dhe nëse janë konstruktive. Mospajtimi me ndonjë politikë të punës nuk do të thotë se personeli mund t'i shpërfillë detyrat e veta. Ata kanë mundësi të shprehin dyshimin e tyre rrëth politikës së punës, procedurave apo udhëzimeve, por prej tyre pritet që këtë ta bëjnë në mënyrë të përshtatshme dhe profesionale.
3. Punonjësit nuk duhet të janë kritikë ndaj punës së institucionit, para të burgosurve dhe publikut në veçanti, të veprosh sipas një praktike të tillë është të inkurajosh mosrespektimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe personelit të saj.
4. Zyrtari duhet të zbatoj me rigorozitet urdhrat e dhëna nga eprorët por gjithashtu duhet të ketë të drejtë të mos zbatojë urdhrat, të cilat janë qartësisht të paligjshëm dhe duhet të njoftoj mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të eprorit për mos zbatimin e urdhërave pa pasur frikë se do të ndëshkohet.

**Neni 11**  
**Mirësjellja**

Mirësjellja e zyrtarëve korrektues, do të reflektohet në mënyrë pozitive në Shërbimin Korrektues të Kosovës si gjatë ashtu edhe jashtë detyrës në përgjithësi. I gjithë personeli do manifestojë sjellje të mirë në mënyrën që mbështet imazhin profesional, si në fjalët e tyre ashtu edhe në vepra.

**Neni 12**  
**Veshja**

1. Zyrtari Korrektues gjatë kryerjes së detyrës zyrtare është i obliguar të bart uniformën zyrtare dhe pajisjet e sigurisë të Shërbimit Korrektues të Kosovës sipas specifikave të përcaktuara.

2. Zyrtarët Korrektues uniformën duhet ta mbajnë të pastër dhe nuk lejohet të ketë ndryshime dhe të vendosen shënja tjera përvèç atyre të përcaktuara zyrtarisht.
3. Këpucet /çizmet, duhet të mbahen si pjese e uniformës çdo herë kur të veshen pantollonat e shërbimit, përjashtimisht këpucët/çizmet mund të jenë ndryshe nga ato zyrtare sipas rekomandimit të mjekut, me kusht që të jenë të përaferta me ato të shërbimit.
4. Nëpunësit civil janë të obliguar që veshjet ti bartin sipas kritereve të përcaktuar me standarde të përgjithshme të Kodit të Etikës për Nëpunësit Civil.

### **Neni 13** **Paraqitja e Zyrtarit Korrektues**

1. Paraqitja e zyrtarit korrektues duhet të jetë serioze, e matur dhe autoritative si brenda ashtu edhe jashtë institucionit, për t'a përfaqësuar sa më denjësish institucionin në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Zyrtari korrektues duhet të bëjë vlerësim të drejt, të jetë i sigurt duke treguar autoritet dhe siguri, mënyra e komunikimit duhet të jetë e qartë dhe e qetë.
3. Çdo zyrtar korrektues është obliguar të bartë ID kartelen në vendin e dukshëm gjatë orarit të punës.
4. Zyrtari korrektues gjatë kryerjes së detyrës zyrtare duhet të jetë i rruar, nëse mban mustaqe ato duhet ti mbaj të shkurtëra, të kufizuara dhe të pastërta, mustaqet nuk mund të lëshohen më shumë se deri te skajet e gojës, gjithashtu edhe flokët duhet ti mbaj të shkurtëra.
5. Zyrtarja korrektuese gjatë kryerjes së detyrave zyrtare flokët duhet ti mbaj në përputhje me standardet. Flokët nuk guxojnë të kalojn jakën e këmishes se uniformës. Në qoftë se zyrtarja mban flokët e gjata, atëherë ato duhet të jenë të mbledhura/mberthyera.
6. Zyrtarët korrektues kur nuk janë të caktuar në orar të punës nuk duhet të bartin uniformën dhe nuk lejohet ekspozimi i pajisjeve të sigurisë.

### **Neni 14** **Marrëdhëniet me zyrtarët tjerë**

1. Marrëdhëniet me anëtarët e tjerë të personelit duhet të nxisin respekt të ndërsjellë brenda Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe të përmirësojnë cilësinë e shërbimit. Personeli pritet t'i kontribuojë ambientit të sigurt dhe të shëndetshëm, pa keqtrajtime dhe diskriminim.
2. Zyrtarët korrektues duhet të respektojnë punën e njëri-tjetrit, si dhe të bashkëpunojnë në mënyrë që të ngritis efikasitetin në punë.
3. Zyrtari korrektues duhet t'i paraqes problemet që shfaqen gjatë ushtrimit të detyrës dhe të diskutoj për gjetjen e zgjidhjeve më efikase me udhëheqësin e drejtpërdrejt.
4. Udhëheqësi duhet të vlerësoj në mënyrë të barabartë, objektive dhe efikase sjelljen e zyrtarëve korrektues, të cilët i udhëheq dhe të mos bëj favorizimin e ndonjë zyrtari korrektues.
5. Udhëheqësi duhet t'i ofrojë zyrtarit korrektues mundësi të barabarta të zhvillimit të karrierës, ngritjes profesionale dhe motivim për efektivitet në punë.

6. Zyrtarët korrektues kanë përgjegjësi të punojnë si pjesë e një ekipi dhe t'i realizojnë objektivat përfshin korrektuese.

**Neni 15**  
**Marrëdhëniet me të burgosurit**

1. Zyrtari korrektues me të burgosurit duhet të sjellet gjithmonë duke respektuar kufijtë e profesionalizmit.

2. Personeli duhet të inkurajojë dhe ndihmojë të burgosurit të risocializohen dhe ti përbahen ligjit. Kjo përfshin krijimin e marrëdhënieve konstruktive, profesionale me të burgosurit përfshin inkurajuar integrimin e serishëm e të suksesshëm të tyre në shoqëri.

3. Marrëdhëniet duhet të tregojnë ndershmëri, drejtësi dhe integritet. Zyrtari Korrektues nuk duhet të krijojë raporte me të burgosurit të cilat i japin favore gjatë ekzekutimit të dënitit.

4. Zyrtarët Korrektues nuk duhet të krijojnë marrëdhënie intime me të burgosurit.

**Neni 16**  
**Sjellja e Zyrtarit Korrektues ndaj Vizitorëve**

1. Gjatë ushtrimit të detyrës, zyrtari korrektues duhet të:

1.1. sjellet në mënyrë profesionale dhe të respektojnë parimin e barazisë, duke përashtuar çdo sjellje diskriminuese ndaj vizitorëve;

1.2. përbahet nga kufizimi i të drejtave të vizitorëve, përvèç kur një kufizim i tillë është i domosdoshem dhe i bazuar me ligj;

1.3. sjellet në mënyrë të përbajtur ndaj vizitorëve, si dhe me një kujdes të veçantë ndaj të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar;

1.4. paraqitet në mënyrë korrekte dhe me përgjegjshmëri gjatë komunikimit të drejtpërdrejtë me vizitorët ose nëpërmjet formave tjera të komunikimit.

1.5. njoftojë me mirësjellje vizitorët mbi procedurat e kontrollit dhe sigurisë, gjërat personale të vizitorëve dhe të burgosurve të ruhen dhe trajtohen me kujdes.

**Neni 17**  
**Shmangia e Konfliktit të Interesit**

1. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në bazë të dhënavë që disponon, duhet të kujdeset që në çdo rast kur vlerëson se mund të ketë konflikt interesit të ndërmarrë veprime përfshinshmangien nga konflikti i interesit.

2. Zyrtari korrektues nuk mund të ngarkohet me detyra që mund të paraqesin konflikt të interesit.

3. Zyrtari korrektues, i cili ka interesa që vazhdimësia e zotërimit të tyre do të përbënte rrezik real për lindjen e konfliktit të interesit dhe do të sillte përjashtimin e vazhdueshëm nga veprimitaria e tij zyrtare ose pamundësinë për të ushtruar detyrat zyrtare, duhet të paraqes konfliktin e interesit për të hequr dorë ose t'i transferoj këto interesa në mënyrë që të shmangë konfliktin e interestit.

**Neni 18**  
**Grevat dhe Protestat**

1. Personeli korrektues nuk ka të drejtë të bëjë grevë, por ka të drejtë t'i shprehë pakënaqësitë e tij nëpërmjet protestave të organizuara dhe të udhëhequra nga organet përfaqësuese dhe sindikale, përderisa nuk rrezikohet funksionaliteti i Shërbimit Korrektues të Kosovës.
2. Në rast të protestave, personelit korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës, i ndalohet që gjatë protestës të bartin armën zyrtare.

**Neni 19**  
**Veprimitaria Sindikale**

Angazhimi i zyrtarit korrektues në kuadër të veprimitarive sindikale është i lejueshme kur nuk pengon në kryerjen e detyrës dhe nuk bie ndesh me natyrën e punës dhe legjislacionin në fuqi.

**Neni 20**  
**Dhuratat**

1. Zyrtari korrektues për kryerjen shërbimit sipas detyrës zyrtare në Shërbimin Korrektues të Kosovës i ndalohet, të kërkojë, pranojë, jap, premitojë, dhurata apo favore në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për vete dhe anëtarët e familjes së tij/saj për kryerjen e një detyre zyrtare apo vendimmarrje.
2. Të gjithë zyrtarët e kanë të ndaluar të marrin pagesë, kompensim apo përfitime nga ndonjë burim tjetër për kryerjen e shërbimit sipas detyrës zyrtare

**Neni 21**  
**Rregullat e përgjithshme të mirësjelljes brenda hapësirave të institucionit**

1. Zyrtari korrektues, në institucion obligohet:

- 1.1. të respektojë rregulloret e brendshme të institucionit;
- 1.2. të kenë kujdes me inventarin dhe pronën e institucionit, pronën e kolegëve dhe pjesëmarrësve tjera në institucion;
- 1.3. të mos dëmtojë hapësirat e gjelbëruara;
- 1.4. të mos konsumoj duhan brenda ndërtesave dhe hapësirave të institucionit, përvëç në vendet e caktuara dhe të lejuara për pirjen e duhanit;

1.5. të mos sjell, konsumoj, e as të jetë nën ndikim të pijeve alkoolike apo substancave tjera dehëse në ambientet e institucionit dhe jashtë institucionit kur është duke bartur uniformën zyrtare;

1.6. të ruaj qetësinë dhe të shmanget nga sjellja e zhurmshme dhe shqetësuese.

**Neni 22**  
**Zbatimi**

1. Njësia e personelit është e detyruar të njoftojë zyrtarin korrektues me rregullat e mirësjelljes që duhen respektuar nga zyrtari korrektues.

2. Shkelja e dispozitave të këtij kodi mund të përbejë shkak për fillimin e procedurës disiplinore në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

3. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i zyrtarit korrektues ka përgjegjësi të mbikëqyrë nëse ai zbaton rregullat e përcaktuara në këtë kod dhe të propozojë ose të marr masat e duhura disiplinore për shkeljet e tij.

**Neni 23**  
**Hyrja në fuqi**

Ky kod hyn në fuqi nga data 01 Prill 2025.

27.03.2025

